REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr.7022 Prot.

Lushnje, më 15/08/2025

RELACION PËRFUNDIMTAR
KËSHILLIT BASHKIAK
Këtu

"PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT BASHKIA LUSHNJE"

Në kuadër të angazhimit të Bashkisë Lushnje për të garantuar një administratë publike efikase, transparente, të përgjegjshme dhe me integritet të lartë, është hartuar Plani i Integritetit Bashkia Lushnje (2025–2028), në përputhje me udhëzimet dhe dokumentet strategjike dhe rregullative përkatëse.Ky plan është rezultat i një procesi gjithëpërfshirës dhe bashkëpunues ndërmjet strukturave të brendshme të bashkisë, duke u mbështetur në:

- Vlerësimin institucional për risqet që prekin integritetin administrativ;
- Rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe institucioneve të tjera të mbikëqyrjes;
- Nevojat konkrete të qytetarëve dhe komunitetit vendor;
- Angazhimin për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe rritjen e besimit publik.

Objektivat kryesore të Planit të Integritetit janë:

1. Forcimi i kuadrit rregullator të brendshëm dhe etikës institucionale;
2. Zvogëlimi i risqeve për shkelje ligjore, abuzime dhe ndikime të papërshtatshme në proceset administrative;
3. Rritja e transparencës dhe llogaridhënies në ofrimin e shërbimeve;
4. Nxitja e një kulture integriteti në të gjitha nivelet e administratës vendore;
5. Bashkëpunimi i qëndrueshëm me AKPA dhe institucione të tjera për promovimin e punësimit dhe praktikave administrative.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e këtij dokumenti për forcimin e qeverisjes së mirë vendore dhe përmbushjen e standardeve të administratës publike,i cili *ka kaluar në Konsultim publik në ambientet e Muzeut Historik Lushnje në datën 15.08.2025 me proces-verbal nr. 7017 prot. datë 15.08.2025, gjatë konsultimit diskutimet janë pasqyruar në procesverbal.*Kërkohet miratimi i tij nga Këshilli Bashkiak.

Ju faleminderit!

KRYETAR I BASHKISË
Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE

Adresa: Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel: +355 35 222139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr.6036Prot.

Lushnje, më 08/09/2025

RELACION
KËSHILLIT BASHKIAK
Këtu

"PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT BASHKIA LUSHNJE"

Në kuadër të angazhimit të Bashkisë Lushnje për të garantuar një administratë publike efikase, transparente, të përgjegjshme dhe me integritet të lartë, është hartuar Plani i Integritetit Bashkia Lushnje (2025–2028), në përputhje me udhëzimet dhe dokumentet strategjike dhe rregullative përkatëse.Ky plan është rezultat i një procesi gjithëpërfshirës dhe bashkëpunues ndërmjet strukturave të brendshme të bashkisë, duke u mbështetur në:

- Vlerësimin institucional për risqet që prekin integritetin administrativ;
- Rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe institucioneve të tjera të mbikëqyrjes;
- Nevojat konkrete të qytetarëve dhe komunitetit vendor;
- Angazhimin për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe rritjen e besimit publik.

Objektivat kryesore të Planit të Integritetit janë:

1. Forcimi i kuadrit rregullator të brendshëm dhe etikës institucionale;
2. Zvogëlimi i risqeve për shkelje ligjore, abuzime dhe ndikime të papërshtatshme në proceset administrative;
3. Rritja e transparencës dhe llogaridhënies në ofrimin e shërbimeve;
4. Nxitja e një kulture integriteti në të gjitha nivelet e administratës vendore;
5. Bashkëpunimi i qëndrueshëm me AKPA dhe institucione të tjera për promovimin e punësimit dhe praktikave administrative.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e këtij dokumenti për forcimin e qeverisjes së mirë vendore dhe përmbushjen e standardeve të administratës publike, kërkohet miratimi nga Këshilli Bashkiak i Planit të Integritetit të Bashkisë Lushnje për periudhën 2025–2028.

Ju faleminderit!

KRYETAR I BASHKISË
Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE

Adresa: Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel: +355 35 222139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr.6836/1 Prot.

Lushnje, më 08/08/2025

PROJEKT VENDIM
Nr. 75 datë 08/08 2025

«PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT BASHKIA LUSHNJE"

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Nenit 8, pika 1, Nenit 9 pika 1, nënpika 1.1, shkronja "a", Nenit 28, gërma "a" të pikës 2 e Nenit 33, Nenit 54 germa "k" të ligjit Nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funskione publike", i ndryshuar, neni 1, pika 2; Ligjit Nr. 8778/2001 "Për ratifikimin e Konventës Penale për Korrupsion", i ndryshuar; Ligjit Nr. 9936, datë 26/06/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë",I ndryshuar; Ligjit Nr. 114/2015 "Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar"; Ligjit Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; LIGJ Nr. 7961, datë 12.7.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë,I ndryshuar,Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; Ligjit Nr. 10296/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar; Ligjit Nr. 9131/2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike", i ndryshuar; Ligjit Nr. 9367/2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksionit shtetëror"; Ligjit Nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik"; Ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", I ndryshuar,Vendimin Nr. 516, datë 01.07.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime dhe shtesa ne VKM nr 247 date 20.03.2015 për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, për periudhën 2015 – 2020" dhe miratimin e Planit Kombetar të Veprimit 2023–2025,

PROPOZOJMË:

1. Miratimin e Planit të Integritetit për vitet 2025-2028 për Bashkinë Lushnje.
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohen të gjitha drejtoritë/njësitë administrative/ndërmarrjet vartëse të Bashkisë Lushnje.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore

Erisa Qafliu

Drejtoria Juridike

Bedri Hida

KRYETAR I BASHKISË
Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE

Adresa: Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel: +355 35 222139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com